



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

29.06.2024

“Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”

ALTERNATIVA (14 x 1 pikë)

1. Cili nga përcaktimet e mëposhtme mbi detyrimin tatimor nuk është i vërtetë:

- a) Detyrimi tatimor lind në rastin kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa apo bëhet pronar i një pasurie, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor.
- b) Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa, në formë të jashtëligjshme, apo behet zotërues i një sendi, në forma të jashtëligjshme.
- c) Detyrimet tatimore mund të llogariten dhe paguhen në monedhë të huaj.
- d) Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat dhe interesat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore dhe legjislacionit për taksat vendore.
- e) (a), (b) dhe (d)

Përgjigja e saktë është alternativa C

2. Cili nga pohimet lidhur me deklaratën tatimore është i gabuar:

- a) Tatimpaguesi dorëzon deklaratë të plotë dhe të saktë tatimore brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin tatimor përkatës;
- b) Deklarata e ndryshuar prej tatimpaguesit mund të dorëzohet brenda 36 muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare, me kushtin që kjo deklaratë të mos jetë kontrolluar më parë nga administrata tatimore
- c) Tatimpaguesi bën vetëdeklarim të shumës së detyrimit tatimor apo të kontributit, pa pritur vlerësimin, njoftimin ose kërkesën nga administrata tatimore, në përputhje me përgjegjësitë tatimore për të cilat është aktiv në organin tatimor;
- d) Tatimpaguesi paguan detyrimin tatimor të vetedeklaruar në afatin dhe vendin e përcaktuar në ligjin tatimor përkatës;
- e) Asnjë nga pohimet më sipër nuk është i vërtetë

Përgjigja e saktë është alternativa E

3. Zgjidhni alternativën e saktë

- a) Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t'u paguar ose shuma e tepricës së kredisë, me vlerë deri në 1000 (një mijë) lekë, vlerësohet në çdo rast si detyrim ose kredi me vlerë zero.
- b) Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t'u paguar për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, me vlerë deri në 1000 (një mijë) lekë, vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero.
- c) Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t'u paguar ose shuma e tepricës së kredisë, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, me vlerë deri në 100 (njëqind) lekë, e cila ka ardhur si rezultat i një vlerësimi të kryer nga administrata tatimore, vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero.
- d) Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t'u paguar ose shuma e tepricës së kredisë, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, me vlerë deri në 1000 (një mijë) lekë, e cila ka ardhur si rezultat i një vlerësimi të kryer nga administrata tatimore, vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero.
- e) Asnjëra nga alternativat

Përgjigja e saktë është alternativa D

4. Cilat nga rastet e mëposhtme quhen 'persona të lidhur'

- a) një kompani ka një interes direkt ose indirekt në një tjetër kompani duke zotëruar më shumë se 50% të saj
- b) personat kanë lidhje familjare midis tyre
- c) quhen personat që kanë lidhje speciale mes tyre, që mund të ketë ndikim direkt në kushtet ose rezultatet e transaksioneve ekonomike që realizojnë me njëri tjetrin
- d) të gjitha më lart të sakta
- e) asnjëra

Përgjigja e saktë është alternativa D

5. Në rastet kur një tatimpagues, për arsye të ndryshme, nuk arrin të paguaj të gjithë shumën e detyrimeve të deklaruara prej vetë atij apo të vlerësuara nga administrata tatimore apo kryen pagesa të paidentifikuara me një tatim specifik, cila është rrada e saktë sipas të cilës shumat e paguara, mbulojnë detyrimet e papaguara dhe të paankimuara të listuara më poshtë:

- A) kostot administrative.
- B) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore e shoqërore dhe ato suplementare
- C) gjobat

- D) tatimi
- E) kamatëvonesat,

Rrethoni alternativën që paraqet rradhën e saktë të mbulimit të detyrimit:

- a) A-B-D-E-C
- b) D-E-C-D-A
- c) B-D-E-C-A
- d) E-D-C-A-B
- e) B-D-C-E- A

Përgjigja e saktë është alternativa C

6. Cili nga pohimet e mëposhtme në lidhje me kamatvonesat është i saktë:

- a) kur tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në kohë, ai detyrohet të paguajë kamatëvonesa
- b) Masa e kamatëvonesës është 120% e normës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, që përcaktohet cdo tremujor
- c) Kamatvonesa paguhet në cdo rrethanë dhe nuk mund të hiqet nga administrata tatimore
- d) Kamatvonesa nuk mund të apelohej, në përjashtim kur ka gabime në llogaritje
- e) kamatvonesa reflekton vlerën në kohë të parasë prandaj nuk është subjekt i kompromiseve
- f) të gjitha pohimet e mësipërme

Përgjigja e saktë është alternativa F

7. Sipas dispozitave të Ligjit për procedurat tatimore në fuqi, tatimpaguesi mund të dorëzojë ankimin e tij kundër çdo njoftim vlerësimi të kryer nga administrata tatimore në drejtorinë e apelimit tatimor

- a) brenda 15 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi
- b) brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi
- c) brenda 45 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi
- d) brenda 60 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi
- e) brenda 90 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi

Përgjigja e saktë është alternativa B

8. Mosplotësimi i saktë i deklaratave tatimore dënohet me:

- a) gjobë të barabartë me 100% të shumës së detyrimit të papaguar
- b) gjobë të barabartë me 50% të shumës së detyrimit të papaguar
- c) gjobë të barabartë me 25% të shumës së detyrimit të papaguar
- d) gjobë të barabartë me 0.06% për çdo ditë të shumës së detyrimit të papaguar, por jo me shumë se 365 dite
- e) 10.000 lekë për cdo deklaratë

Përgjigja e saktë është alternativa D

9. Rrethoni alternativën e saktë:

- a) Humbja në tatimin korporativ nuk kompensohet me fitimet e tatueshme në vitet e ardhshëm fiskalë.
- b) Humbja në tatimin korporativ, kompensohet me fitimet e tatueshme në 3 vjetët e ardhshëm fiskalë.
- c) Humbja në tatimin korporativ, kompensohet me fitimet e tatueshme në 4 vjetët e ardhshëm fiskalë.
- d) Humbja në tatimin korporativ, kompensohet me fitimet e tatueshme në 5 vjetët e ardhshëm fiskalë.
- e) Humbja në tatimin korporativ, kompensohet me fitimet e tatueshme në 10 vjetët e ardhshëm fiskalë.

Përgjigja e saktë është alternativa D

10. Tatimpaguesi i tatimit mbi të ardhurat personale me të ardhura vjetore të tatueshme 2 000 000 lekë nuk mund të zbresë:

- a) Kompensimin për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç prej 48 000 lekësh;
- b) Zbritje tatimore prej 420 000 lekësh.
- c) Shpenzimet korrente për arsimin e fëmijëve në ngarkim të tij, në vlerën maksimale 100 000 lekë;
- d) (a) + (b)
- e) (b) + (c)

Përgjigja e saktë është alternativa E

11. Nje institucion mjekësor A (spital) i licencuar si të tillë nga autoriteti kompetent shëndetësor ofron shërbimet shëndetësore. Spitali (A) lidh një kontrate me nje institucion mjekësor (B) tjetër. Ojekti i kontrates eshte ofrimi i sherbimeve mjeksore per spitalin B, nepermjet personelit mjekësor te spitalit A. Cilen shkalle tatimore do te aplikojë Spitali A?

- a) 20%
- b) Te perjashtuar
- c) 6%
- d) 0%
- e) Pjesërisht me 20 %, pjesërisht të përjashtuar

Përgjigja e saktë është alternativa A

12. Kompania X ushtron aktivitetin në fushën e mediave audiovizive (televizion). Kompania X furnizon (shet) një program për një televizion tjetër Y. Gjeni alternativën e saktë:

- a) Personi i tatueshëm A lëshon fature me shkalle tatimore 6%
- b) Personi i tatueshëm A lëshon fature për të cilën nuk apikon TVSH (Te perjashtuar)
- c) Personi i tatueshëm A lëshon fature me shkalle tatimore 20%
- d) Personi i tatueshëm A lëshon fature me shkalle tatimore 10%
- e) Personi i tatueshëm A lëshon fature me shkalle tatimore 0%

Përgjigja e saktë është alternativa C

13. Metodologjia për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme – ndërtesa bëhet nga:

- a) Këshilli i Ministrave
- b) Kryetari i Bashkisë
- c) Këshilli Bashkiak
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- e) Të gjitha më sipër

Përgjigja e saktë është alternativa A

14. Gjeni alternativën e saktë. Akciza është një taksë që zbatohet mbi produktet e akcizës, të prodhuara dhe të importuara:

- a) që hidhen për konsum jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- b) që hidhen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- c) që qëndrojnë në magazine doganore në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- d) që kalojnë tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- e) që hidhen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës.

Përgjigja e saktë është alternativa B

PYETJE ME SHITJELLIM (4 pikë secila pyetje)

Pyetje 1: Përshkruani çfarë të drejtash dhe detyrimesh ka agjenti i mbajtjes së tatimit dhe cilat janë detyrat plotësuese të tij.

Përgjigje:

Me përjashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe, agjenti i mbajtjes së tatimit ka të njëjtat të drejta dhe detyrime me një tatimpagues.

Agjenti i mbajtjes së tatimit ka edhe këto detyra plotësuese:

- a) të llogarisë saktësisht dhe të mbajë tatimin për një tatimpagues;
- b) të paguajë tatimin në Buxhetin e Shtetit, në datën e përcaktuar në ligj;
- c) të mbajë regjistrime për të ardhurat e paguara dhe për tatimet e mbajtura të të gjithë tatimpaguesve dhe të pagesave, të transferuara në Buxhetin e Shtetit;
- ç) t'i japë administratës tatimore informacion të saktë për deklaratat e tatimpaguesve në datën e duhur, të përcaktuar në ligj;
- d) të kryejë të gjitha detyrat e tjera, të parashikuara nga dispozitat ligjore në fuqi.

Pyetje 2: Cilat janë llojet e kontrolleve tatimore që kryen administrata tatimore. Specifikoni në mënyrë të përmbledhur ku bazohen dhe vecantitë për secilin, për aq sa parashikohet në Ligjin për Procedurat tatimore, në fuqi.

Përgjigje:

Kontrollet tatimore janë:

a) Kontroll tatimor i plote në vend. Këto kontrolle janë gjithëpërfshirëse dhe ndërmerren për të kontrolluar të gjitha aspektet e biznesit të personit të tatueshëm për të gjitha periudhat kohore që nga kontrolli i plote i fundit dhe të gjithë llojet e tatimeve. Këto kontrolle kryhen bazuar në analizën e riskut.

b) Vizitat fiskale.

Këto janë kontrolle të shkurtra të kryera gjatë një periudhe të shkurtër kohore për të verifikuar saktësinë e deklaratave dhe pagesave, si rregull vetëm për një periudhe të caktuar tatimore dhe vetëm për një lloj tatimi. Në rastet kur nga këto vizita fiskale konstatohen probleme serioze dhe dyshime të bazuara për fshehje tatimi, kontrollori propozon kryerjen e një kontrolli të plote në vend.

c) Verifikimet në vend. Këto verifikime të shkurtra synojnë zbulimin në kohe të shkeljeve që kanë lidhje me regjistrimin e personave të tatueshëm (identifikimin e personave të peregjistruar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale në mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin faturave tatimore, etj. Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak të personave të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit, të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin e ditës, të lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend.

d) Kontrolli që kryhet me objekt “Transferimin e çmimit” është kontroll specifik që kryhet në zbatim të dispozitave perkatase të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe udhëzimit “Për transferimin e çmimit”. Nëse një tatimpagues është kontrolluar më parë për tatim fitimin, por nuk është kontrolluar për qëllime të transferimit të çmimit në zbatim të dispozitave për këtë qëllim, atëherë kontrolli për transferimin e çmimit nuk konsiderohet rikontroll tatimor në kuptim të nenit 85 të ligjit dhe pikës 85 të këtij udhëzimi.

Pyetje 3: Përshkruani shkurtimisht procedurën e rimbursimit të TVSH-së sic parashikohet në ligjin për procedurat tatimore në fuqi. Cilat janë kriteret ligjore që duhet të përmbushen nga një person i tatueshëm për TVSH-në për të gëzuar të drejtën që të paraqesë kërkesën për rimbursimin e TVSH-së, mënyren dhe afatet që duhet te respektojë. Cilat janë organet e administratës tatimore që marrin pjesë në procesin e miratimit dhe veprimet që ndermarrin kur është e nevojshme. Afati i kryerjes së kthimit të tepricës kreditore të rimbursueshme të TVSH-se nga thesari dhe çfare e drejte i lind tatimpaguesit në rast të mosmarrjes së pagesës.

Përgjigje:

Personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, që rezultojnë me tepricë kreditore, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Kushtet ligjore konsistojnë si me poshtë:

i) Për tatimpaguesit e përcaktuar si eksportues duhet teplotesohen kriteret e VKM-së nr. 953, datë 29.12.2014 "Përdispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbivlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përkëtë qëllim, nevojitet plotësimi i kriterit ligjor, nëse teprica e TVSH-së së zbritshme të kërkuar për rimbursim është më e madhe se 400.000 lekë;

ii) Për tatimpaguesit e tjerë joeksportues, verifikimin e plotësimit të kriterit ligjor, nëse rezulton me TVSH-në të zbritshme për secilën nga tri periudhat e njëpasnjëshme, shumë e cila pas këtyre tri periudhave duhet të jetë më e madhe se 400.000 (katërqind mijë) lekë.

Kërkesa paraqitet sipas formularit të miratuar “Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së. Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepricën kreditore si të rimbursueshme.

Kur është e nevojshme, administrata tatimore ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut.

Pagesa e tepricës kreditore të rimbursueshme kryhet brenda pesë ditëve, nëpërmjet sistemit të

thesarit, në bazë të rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masë TVSH-së së pretenduar për rimbursim.

Pyetje 4: Kush janë të ardhurat dhe pagesat objekt i tatimit të mbajtur në burim? Rastet e mbajtjes dhe të mos mbajtjes së tatimit në burim?

Përgjigje:

A. Tatimi mbahet në burim, për pagesat e bëra për një tatimpagues rezident shqiptar, ose një selie të përhershme të një jorezidenti.

1. Pagesat për të cilat tatimi mbahet në burim

Të ardhurat dhe pagesat objekt i mbajtjes së tatimit në burim, janë :

- a) dividendët;
- b) interesat;
- c) honoraret;
- ç) të ardhurat nga lojërat e fatit;
- d) të ardhurat nga qiradhënia vetëm kur i paguhen individit.

2. Raste konkrete të mbajtjes së tatimit në burim

a) Për të ardhurat nga *dividendi*, që entiteti shpërndan :

(i) Kur përfituesi është Individ apo Person Fizik, në të gjitha rastet.

(ii) Kur përfituesi është Entitet, në kushtet që :

- përfituesi zotëron më pak se 10% të kapitalit/aksioneve/të drejtave të votës, në entitetin shpërndarës;
- përfituesi zotëron më shumë se 10% të kapitalit/aksioneve/të drejtave të votës, në entitetin shpërndarës, por ruajtja e pjesëmarrjes është më pak se 24 muaj dhe përfituesi, nuk ka vendosur një garanci për llogari të administratës tatimore.

b) Për pagesa për *honoraret* mbahet tatimi në burim, pavarësisht se përfituesi i të ardhurës është entitet, person fizik apo individ.

c) Për pagesa për *lojrat e fatit*, tatimi mbahet ndaj përfituesve që janë individë.

ç) Për pagesa për *qiratë*, mbahet tatimi në burim, vetëm kur qiradhënësi, përfitues i të ardhurës, është individ.

B. Tatimi mbahet në burim për pagesat e bëra, për person fizik jorezident shqiptar, apo entitet jorezident shqiptar

Të ardhurat dhe pagesat objekt i mbajtjes së tatimit në burim, janë :

a) Dividendët, interesat dhe honoraret, kur nuk ka Marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në çdo rast mbahet tatimi në Shqipëri.

b) Fitimet nga lojërat e fatit, tatimi mbahet në Shqipëri.

c) Pagesat e shërbimeve (në nenin 4 të ligjit), përveç shërbimeve të marra fizikisht jashtë Shqipërisë.

- c) Shërbimet e sigurimit, tatimi mbahet në Shqipëri.
- d) Tarifat për pjesëmarrjen në bordet drejtuese dhe këshillat ose trupa drejtues të tjera, taten në Shqipëri, pavarësisht faktit se takimi i bordit, etj., zhvillohet në Shqipëri, *online* apo në vend tjetër.
- dh) Pagesat për ndërtime, instalime, montime ose punë mbikeqyrese, , kur nuk ka Marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në çdo rast mbahet tatimi në Shqipëri.
- e) Pagesave për performancën e aktorëve, muzikantëve ose sportistëve, përfshirë të ardhurat nga personat që punësojnë artistë ose sportistë, ose vepronë si ndërmjetës në organizimin e shfaqjeve apo të performancave, i mbahet tatimi në Shqipëri, si vend ku zhvillohet aktiviteti, pavarësisht se ka marrëveshje në fuqi.

C. Të ardhura për të cilat nuk mbahet tatimi në burim

Nuk mbahet tatimi në burim për të ardhurat e mëposhtëme :

- a) Të ardhurat e paguara personave të perjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat;
- b) Të ardhurat nga dividendët që entiteti shpërndan, për një entitet, në kushtet që njëkohësisht :
 - (i) përfituesi zotëron mbi 10% të kapitalit/aksioneve/të drejtave, në entitetin shpërndarës ;
 - (ii) me ruajtje të pjesëmarrjes për të paktën 24 muaj;
 - (iii) me ruajtje të pjesëmarrjes më pak se 24 muaj, por vendos garanci për administratën tatimore.
- c) Të ardhurat nga fitimi kapital, si dhe të ardhurat nga interesat nga emetimi i eurobondit prej Shqipërisë, të paguara entiteteve jorezidente, pa një seli të përhershme në Shqipëri;
- d) Të ardhurat nga interesat që u paguhen bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

Pyetje 5: Kush janë fitimet kapitale nga rivlerësimi i aktiveve të biznesit dhe rastet e mundshme të rivlerësimit?

Përgjigje:

Përfshihen në të ardhurat e biznesit, fitimet kapitale nga rivlerësimi i aktiveve të biznesit. Aktive të biznesit janë ato që janë dhënë si kontribut në natyrë në kapitalin e një entiteti :

- në themelimin e entitetit,
- për rritjen e kapitalit të entitetit.

1. Aktivi është i rivlerësuar sipas ligjeve për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme

Nëse aktivi :

- (i) është i rivlerësuar sipas ligjeve për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme ;
- (ii) tatimi në lidhje me këto rivlerësime është paguar,

Shuma e rivlerësuar e aktivitetit :

- nuk konsiderohet e ardhur nga biznesi ;
- nuk konsiderohet si shpenzim biznesi, pra nuk llogaritet amortizimi mbi të.

Në rastin e shitjes së aktivitetit të rivlerësuar, fitimi kapital nga shitja e aktivitetit llogaritet si diferencë ndërmjet

- (i) çmimit të shitjes dhe
- (ii) vlerës së rivlerësuar.

2. Aktivi nuk është i rivlerësuar sipas ligjeve për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme

Në rastet kur rivlerësimi i aktivitet është bërë jo në zbatim të ndonjë ligji specifik për rivlerësimin e pasurisë, por nga vetë entiteti, atëherë :

Shuma e rivlerësuar e aktivitet :

- nuk konsiderohet e ardhur nga biznesi ;
- nuk konsiderohet si shpenzim biznesi, pra nuk llogaritet amortizimi mbi të.

Në rast të shitjes së aktivitet të rivlerësuar, nuk merret në konsideratë fitimi kapital nga shitja e aktivitet.

3. Aktivi është rivlerësuar para futjes si aktiv i biznesit, dhe ky rivlerësim nuk është bërë sipas ligjeve në lidhje me rivlerësimin e pasurive të paluajtshme.

Nëse aktivi është rivlerësuar para futjes si aktiv i biznesit, dhe ky rivlerësim nuk është bërë në kuadrin e ligjeve të miratuara në lidhje me rivlerësimin e pasurive të paluajtshme, atëherë :

Shuma e rivlerësuar e aktivitet :

- konsiderohet e ardhur nga biznesi ;
- konsiderohet si shpenzim biznesi, pra llogaritet amortizimi mbi të.

Pyetje 6: Kush janë furnizimet që janë me shkallë të reduktuar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe shkallët tatimore përkatëse?

Përgjigje:

Përveç shkallës standarde të TVSH-së, kur parashikohet në këtë ligj, mund të aplikohet shkalla e reduktuar e TVSH-së, e cila aplikohet si një përqindje e vlerës së tatueshme.

1. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind. Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Përjashtimisht sa përcaktohet në pikën 3, të këtij neni, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 % aplikohet për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”. Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Për strukturat, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, aplikohet shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit, me përjashtim të pijeve. Personi i tatueshëm, që aplikon shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6 për qind, është personi i regjistruar me NIPT/NUIS, vetëm për zhvillimin e veprimtarisë pritëse të certifikuar si “agroturizëm”

4. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të

reklamave nga media audiovizive, është 6 për qind.

5. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mjeteve të transportit publik të licencuar të udhëtarëve me autobus me nëntë plus një vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik, është 6 për qind.

6. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e librave të çdo lloji, është 6 për qind.

7. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të punimeve të ndërtimit për investimet shtetërore të klubeve sportive/federatave sportive apo për investimet e subjekteve private në infrastrukturën sportive, të përcaktuar në legjislacionin e fushës për sportin, është në nivelin 6 për qind.

8. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e inputeve bujqësore, ku përfshihen plehurat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, me përjashtim të hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave, është 10 për qind. Lista e kategorive të inputeve bujqësore, sipas këtij neni, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pyetje 7: Si llogaritet koeficienti i zbritjes së TVSH-së dhe kush janë vlerat që nuk merren parasysh për llogaritjen e koeficientit?

Përgjigje:

Koeficienti i zbritjes së TVSH-së llogaritet nga raporti i mëposhtëm:

a) në numërues, shumën totale të vëllimit të xhiros vjetore, pa TVSH-në, lidhur me transaksionet që sjellin të drejtën e zbritjes, sipas neneve 69 dhe 70, të këtij ligji.

b) në emërues, shumën totale të vëllimit të xhiros vjetore, pa TVSH-në, lidhur me transaksionet e përfshira në numërues dhe me transaksionet që nuk sjellin të drejtën e zbritjes.

Për llogaritjen e koeficientit të zbritjes së TVSH-së, nuk merren parasysh shumat e mëposhtme:

a) vlera e qarkullimit të realizuar nga furnizimet e mallrave kapitale, të përdorura nga personi i tatueshëm për nevoja të biznesit së tij;

b) vlera e qarkullimit, të realizuar nga transaksione financiare dhe të pasurive të paluajtshme nëse këto transaksione janë rastësore;

c) vlera e qarkullimit, të realizuar nga transaksione të përcaktuara nga shkronja “b” deri në “e”, të nenit 53, të këtij ligji, nëse këto transaksione janë rastësore

Pyetje 8: Listo dhe përshkruaj shkurtimisht 4 lloje taksash vendore.

Përgjigje:

Taksat vendore përfshijnë: taksën mbi pasurinë e paluajtshme (ndërtesat, tokën bujqësore, truallin), taksën e fjetjes në hotel, taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksën

mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, taksën e tabelës dhe taksa të përkohshme. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe disa taksa të tjera janë shfuqizuar me ligje të ndryshme të botuara në Fletoren Zyrtare.

Pyetje 9: Çfarë parashikon regjimi i përpunimit aktiv? Nga se kushtëzohet përdorimi i këtij regjimi?

Përgjigje:

Regjimi i përpunimit është një regjim doganor i cili lejon mallrat joshqiptare të përdoren në territorin doganor shqiptar, në një ose më shumë operacione përpunimi, të destinuara për t'u riekportuar nga ky territor doganor në formën e produkteve kompensuese, pa iu nënshtruar detyrimeve doganore të importit, pagesave apo masave të tjera, sipas parashikimeve në dispozitat përkatëse në fuqi të Kodit Doganor dhe aktëve nënligjore në zbatim të tij.

Regjimi i Përpunimit Aktiv ka në thelb eksportimin e punës, teknologjisë dhe faktorëve të tjerë ekonomike që në mënyrë direkte bëjnë transformim të thjeshtë apo përfundimtar në mallra të gatshëm, për t'u përdorur si produkte në operacione të tjera përpunimi, montimi, apo për konsum.

Përdorimi i këtij regjimi doganor ekonomik kushtëzohet nga lëshimi i autorizimit nga autoritetet doganore kompetente me përmbushjen e kriterëve specifike, ndër të cilat mund të përmendim:

- a) Personave duhet të jenë të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- b) Të ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për kryerjen e operacioneve të përpunimit;
- c) Autoritetet doganore mund të mbikëqyrin e kontrollojnë regjimin.
- d) Në rastet e lindjes së një borxhi doganor ose detyrime të tjera për mallra të vendosura nën një regjim të posaçëm, ata japin një garanci në përputhje me dispozitat e kodit doganor;
- e) Autorizimi i lëshohet personave që kryejnë operacionet e përpunimit mbi mallrat ose marrin përsipër kryerjen e tyre, në bazë të kontratave të porosisë me Shoqëri të Huaja për përpunimin e mallrave.

USHTRIME (5 pike)

Ushtrimi 1 (5 pikë)

Gjatë një vizite fiskale të kryer pranë një subjekti tregtar të artikujve të ndryshem industrial lidhur me verifikimin e inventarit, inspektorët tatimor konstatojnë në ambientet e subjektit mall të pashoqëruar me faturë. Sipas të dhënave në e-filing subjekti rezulton subjekt i regjistruar për përgjegjësinë tatimore të TVSH-si dhe të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi dhe kjo shkelje nuk është e përsëritur.

- a) Duke qënë se subjekti në fjalë është i regjistruar për TVSH-në si do të veprojë ai për të dokumentuar mallin në fjalë, referuar dispozitave të Ligjit për procedurat tatimore në fuqi?
- b) Cfarë gjobe aplikohet në këtë rast lidhur me mallrat e pashoqeruara me fature dhe sa do të jete vlera e saj duke pasur parasysh që vlera në shitje sipas cmimit të tregut e mallit të pashoqëruar me faturë, referuar vlerësimit të berë nga ana e inspektoreve tatimore, rezulton të jetë 720.000 Lekë (përfshirë TVSH)?

A ka kryer ky subjekti në këtë rast shkelje që konsiderohet edhe evazion tatimor?

Përgjigje:

- a) Duke qene se subjekti ne fjale eshte i regjistruar për TVSH-në, ai detyrohet të dokumentojë mallin gjendje duke lëshuar faturë tatimore, pa aplikuar TVSH-ne. Kjo faturë nuk është dokument për njohjen si shpenzim i zbritshëm,
- b) Lidhur me konstatimin e mallrave te pashoqeruara per tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi apo vetëpunësimi dhe për TVSH-në aplikohet gjobë prej 50 000 lekësh, por jo më pak se vlera e TVSH-së së munguar.

vlera e TVSH-se se munguar sipas vleresimit eshte :
 $720000/6=120000$ LEKE

Pra subjekti do te penalizohet me 120000 LEKE.

Duke qene se shkelja nuk eshte e perseritur, atehere subjekti nuk do te jete objekt i penalizimeve qe lidhen me evazionin tatimor.

Ushtrimi 2 (5 pikë)

Tatimpaguesi “D”, subjekt tregtar dëshiron të ndërprese aktivitetin për nje periudhe te pacaktuar, duke filluar nga data 30 qershor 2024. Aktualisht ai ka detyrime tatimore te papaguara, të cilat i shfaqen në llogarinë e tij në e-filing dhe për të cilat janë gjeneruar urdhërpagesat përkatëse.

- a. Përshkruani hapat që duhet të ndjekë Tatimpaguesi dhe detyrimet që ai ka për deklarim pas datës së miratimit të pezullimit të aktivitetit.
- b. Nëse tatimpaguesi ka lidhur dhe ka aktive një marreveshje të pagesës me këste me Drejtorinë Rajonale Tatimore, a mund të aplikojë për pezullim aktiviteti?
- c. Si mund të rifillojë subjekti ushtrimin e aktivitetit?

Përgjigje:

a) Tatimpaguesi duhet të paguaje të gjitha detyrimet e papaguara që i shfaqen në sistem. Me pas të aplikojë në QKB për pezullim të aktivitetit me afat të pacaktuar.

Pavaresisht miratimit të pezullimit të aktivitetit, duhet të deklarojë deklaratat tatimore dhe paguaje detyrimet për periudhat përfshirë Qershor 2024 dhe deklaratën vjetore 2024, brenda afateve ligjore.

Për periudhat Korrik 2024 e në vijim, për sa kohë është pasiv, nuk i gjenerohen deklaratat tatimore dhe nuk ka detyrim për të deklaruar dhe paguar.

b) Tatimpaguesi nuk mund të pezullojë aktivitetin, nëse ka lidhur dhe ka aktive një akt-marreveshje për pagese me këste të detyrimeve

c) Tatimpaguesi duhet të bëjë kërkesë për riaktivizim në QKB përpara rifillimit të aktivitetit.

Ushtrimi 3 (5 pikë)

Punëmarrësi “AZ”, në vitin 2024, ka përfituar të ardhura në natyrë nga punëdhënësi i tij, të cilat sipas llojeve paraqiten :

- qira të paguar punëmarrësit nga punëdhënësi, në shumën 200,000 lekë;
- laptop për përdorim për nevoja pune, me vlerë 80,000 lekë;
- pagesa për trajtime mjekësore, në shumën 150,000 lekë;
- pagesa për udhëtim dhe akomodim privat për pushimet vjetore 190,000 lekë;
- shpenzimet telefonike përpërdorim gjatë punës, në shumën 60,000 lekë;
- mallra ushqimore në shumën 70,000 lekë;
- tollona karburanti për automjetin privat, në shumën 50,000 lekë;
- lidhje interneti në shtëpi për të komunikuar me punëdhënësin 30,000 lekë;

Përcaktoni shumën totale të të ardhurave personale të tatueshme dhe të patatueshme për punëmarrësin “AZ”.

Përgjigje:

a) Konsiderohen të ardhura personale të tatueshme :

- qira të paguar punëmarrësit nga punëdhënësi, në shumën 200,000 lekë;
- pagesa për trajtime mjekësore, në shumën 150,000 lekë;
- pagesa për udhëtim dhe akomodim privat për pushimet vjetore, 190,000 lekë;
- mallra ushqimore në shumën 70,000 lekë;

- tollona karburanti për automjetin privat, në shumën 50,000 lekë;
Totali i të ardhurave personale të tatueshme : 660,000 lekë.

b) Konsiderohen të ardhura personale të patatueshme :

- laptop për përdorim për nevoja pune, me vlerë 80,000 lekë;
- lidhje interneti në shtëpi për të komunikuar me punëdhënësin 30,000 lekë;
- shpenzimet telefonike në funksion të aktivitetit të entitetit, në shumën 60,000 lekë;

Totali i të ardhurave personale të patatueshme : 170,000 lekë.

Ushtrimi 4 (5 pikë)

a) Për vitin 2024, entiteti “A17” ka rezultuar me fitim korporativ të tatueshëm 150,000,000 lekë. Shpenzimet e sponsorizimit, për ekipin lokal të federuar të futbollit janë 7,500,000 lekë.

Llogaritni tatimin mbi fitimin korporativ për vitin 2024.

b) Për vitin 2025, entiteti “A17” ka rezultuar me fitim korporativ të tatueshëm 200,000,000 lekë. Shpenzimet e sponsorizimit, për ekipin lokal të federuar të futbollit janë 15,000,000 lekë,

Llogaritni tatimin mbi fitimin korporativ për vitin 2025.

Përgjigje:

a) Për vitin 2024

Shuma e sponsorizuar është 5% e fitimit para tatimit, aq sa norma e lejuar e sponsorizimit prej 5% e fitimit para tatimit.

Për llogaritjen e tatimit mbi fitimin, shumën e sponsorizuar 7,500,000 lekë njihet si shpenzim i zbritshëm sa trefishi i saj, pra 22,500,000 lekë.

Tatim mbi fitimin korporativ i llogaritur për t’u paguar është :

$(150,000,000 - 22,500,000 \text{ lekë}) \times 15\% = 19,125,000 \text{ lekë}$

b) Për vitin 2025

Shuma e sponsorizuar është 7,5% e fitimit para tatimit, pra 2,5% më e madhe se norma e lejuar e sponsorizimit, prej 5% e fitimit para tatimit.

Për llogaritjen e tatimit mbi fitimin, vetëm shumën e sponsorizuar prej 10,000,000 lekë, njihet si shpenzim i zbritshëm sa trefishi i saj, pra 30,000,000 lekë.

Tatim mbi fitimin korporativ i llogaritur për t’u paguar është :

$(200,000,000 - 30,000,000 \text{ lekë}) \times 15\% = 25,500,000 \text{ lekë}$

Ushtrimi 5 (5 pikë)

Bazuar në të dhënat e rezultatit financiar (fitim/humbje) të tabelës, si dhe faktit që nuk ka humbje të mbartur nga vitit 2023, plotësoni për çdo vit, sipas kolonave:

Humbjen e lejuar për mbartje nga periudha e mëparshme, fitimin/humbjen pas mbartjes së humbjeve të kaluara, fitimin e tatueshëm.

milion lek

Nr.	Vitet	Fitimi/ humbja	Humbja e lejuar për mbartje nga	Fitimi/humbja e vitit pas mbartjes së	Fitimi i tatueshëm
-----	-------	-------------------	------------------------------------	------------------------------------------	-----------------------

		tatimore	periudhat e mëparshme	humbjeve të kaluara	
1	2024	-20	0		
2	2025	2			
3	2026	4			
4	2027	2			
5	2028	6			
6	2029	4			
7	2030	12			

Përgjigje:

Nr.	Vitet	Fitimi/humbja tatimore	Humbja e lejuar për mbartje nga periudhat e mëparshme	Fitimi/humbja e vitit pas mbartjes së humbjeve të kaluara	Fitimi i tatueshëm
1	2024	-20	0	-20	0
2	2025	2	-20 (2024)	-18	0
3	2026	4	-18 (2024)	-14	0
4	2027	2	-14 (2024)	-12	0
5	2028	6	-12 (2024)	-6	0
6	2029	4	-6 (2024)	-2	0
7	2030	12	0	12	12

Ushtrimi 6 (5 pikë)

Nje shoqeri kryen veprimtari ekonomike ne fushen e sherbimit taksi e regjistruar ne maj 2024. Me fillimin e aktivitetit te saj shoqeria blen 10 automjete me motorr elektrik, të reja, me zero km e që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër. Shoqeria i regjistron automjetet ne emer te vetë. Shoqeria ne muajin Maj 2024 realizon transaksionet perfundimtare (perfshire TVSH) si me poshte:

- Sherbim taksi----- 120.000 leke
- Blerje energjie elektrike --- 36.000 leke
- Blerje automjete ----- 20.000.000 leke
- Shet njerem prej makinave që ka përdorur -----1.800.000 leke

Si do deklarohen transaksionet e mesiperme?

Sa TVSH duhet te paguaj shoqeria e taksive?

Përgjigje:

VT

TVSH

Shitje te tatueshme	1.600.000	320.000
Blerje me tvsh te zbriteshme	30.000	6.000
Blerje me tvsh jo te zbriteshme	20.000.000	
Tvsh per tu paguar	326.000 leke	

Ushtrimi 7 (5 pikë)

Nje klinike dentare A person i tatueshem i regjistruar per TVSH, ka lidhur kontrate bashkepunimi me nje person te tatueshem B rezident ne Itali. Shoqeria B i ofron shoqerise A gjetjen e klienteve per te marre sherbimin dentar te kjo e fundit.

Ne muajin maj 2024 shoqeria B leshon fature shqerise A me vlere 5.000 euro, ekuivalenti ne leke 500.000 leke (pershkrimi ne fature eshte kliente per shoqerine A).

Shoqeria A ne kete muaj ka leshuar fatura shitje per kliente te ndryshem, me vlere ne total 100.000 lekë (pershkrimi ne faturat e leshuara eshte, sherbim dentar).

Shoqeria A po ne kete muaj ka kryer blerje:

Energji elektrike ----- 80.000 leke me gjithë tvsh

Uje----- 5.000 leke me gjithë tvsh

Paisje dentare----- -- 100.000 leke me gjithë tvsh

Per transaksionet e mesiperme si do te behet deklarimi per efekt TVSH-je?

A duhet te paguajë TVSH Shoqeria A?

Përgjigje:

Deklarimi ne deklaraten e tvsh:

Shitje te perjashtuara 100.000 leke

Autongarkese ne shitje vlere e tatueshme 500.000 leke tvsh 100.000

Blerje me tvsh jo te zbriteshme 785.000 leke

Tvsh per tu paguar 100.000 leke

Ushtrimi 8 (5 pikë)

Nje person i tatueshem ushtron veprimtarine e tij ekonomike ne fushen tregetise se kondicionereve gjate periudhes qershor 2024 kryen keto transaksione:

Nr.	BLERJE	Periudha	Vlere e tatue	TVSH
1	KONDITIONER	Dhjetor	500.000	100.000
2	Shpenzime udhëtime e dieta, strehimin në hotele	Dhjetor	50.000	10.000
3	Autoveture	Dhjetor	200.000	40.000
4	Kamion per transport malli	Dhjetor	1.000.000	200.000
	Shpenzime energji, uji, internet	Dhjetor	50.000	10.000
5	Kompjuterat per punonjesit	Dhjetor	100.000	20.000
6	Shpenzime per Zbukurimin e ambjenteve te punes per festat e fund vitit			
7		Dhjetor	20.000	4.000

Nr.	Shitje te tatueshme	Periudha	Vlere e tatue	TVSH
1	KONDITIONER	Dhjetor	2.000.000	400.000
2	Sherbim Vendosje kondicionerash		100.000	20.000

Sa TVSH duhet te paguaje shoqeria?

Përgjigje:

Shitje te tatueshme

Kondicioner 400.000 tvsh+ sherbim kondiciner 20.000 tvsh= 420.000 tvsh.

BLerje: kondicioner 100.000+ kamion 200.000 tvsh+ enrgji, uje, 10.000,tvsh + komjuterat 20.000 tvsh= 330.000 tvsh.

420.000 - 330.000 = 90.000

Shenim: per vlerat e tvsh, shp .dieta 10.000 tvsh, autoveture 40.000 tvsh, zbukurim ambjentesh, 40.000 tvsh nuk lejohet zbritja e tvsh, prandaj nuk ka efekt.

Ushtrimi 9 (5 pikë)

Edi, është i punësuar pranë shoqërisë distributore të pijeve energjike O2 shpk me vendndodhje në Tiranë në pozicionin e agjentit të shitjes. Sipas kontratës së punës Edi ka një pagë fikse prej 70,000 lekë. Ai gjithashtu sipas kontratës përfiton dhe komision 1.5% mbi shitjet mujore. Për muajin Maj 2024, Edi ka realizuar shitje në vlerën 5,000,000 lekë të produkteve. Në rastet kur ai shkon për të gjetur klientë dhe zgjeruar klientelën në Durrës, ai përfiton kompensim ushqimor në masën 1,000 lekë dita. Në muajin Maj ai ka qenë për 7 ditë në Durrës. Gjithashtu për festa, Edi ka përfituar një shpërblim në vlerën 10,000 lekë. Edi ka munguar në punë tre ditë gjatë muajit maj, justifikuar

sipas raportit shëndetësor. Politika e kompanisë është që të paguhet në masën 80% të pages, për mungesat e justifikuara me raport.

Kërkohet:

- a. Përcaktoni kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për Edin, për punëmarrësin dhe punëdhënësin. (3 pikë)

Zgjidhje (1.5 pikë për caktimin e pagës dhe 1.5 pikë për llogaritjen e kontributeve)

Paga për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore:

Shpërblimet e përfituara:	Paga	Shenime mbi llogaritjen
Elementi pagës fikse për 19 ditë	60,455	(70000 Lekë/22*19)
Paga Variabël 1.5% mbi shitjet mujore	75,000	(1.5%* 5,000,000 Lekë)
Kompensim ushqimor 7 ditë * 1,000 lekë dita	-	nuk përfshihet
Shpërblim për festa 10,000 lekë	-	nuk përfshihet, jo info qe eshte e vazhdueshme
Paga për 3 ditë e paguar nga punëdhënësi	7,636	(80%*70,000 Lekë/22*3)
Paga Total	143,091	
Kontributet e sigurimeve shoqërore punëdhënësi 15%	21,464	
Kontributet e sigurimeve shëndetësore punëdhënësi 1.7%	2,433	
Total Punëdhënësi	23,896	
Kontributet e sigurimeve shoqërore punëmarrës 9.5%	13,594	
Kontributet e sigurimeve shëndetësore punëmarrës 1.7%	2,433	
Total Punëmarrës	16,026	

- b. A ka përjashtime në llojin e shpërblimeve apo përfitimeve, në kuadër të llogaritjes së pagës bruto për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore dhe shëndetësore? (2 pikë)

Përgjigje:

Paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e të kujdesit shëndetësor, është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi, ose në kontratën e punës, sipas rastit, me kohë ose vëllim pune dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës.

Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor, nuk përfshihen:

- a) përfitimet që punëmarrësi merr nga fondet e sigurimeve shoqërore;
- b) kompensimet nga rritja e çmimeve;
- c) dhuratat në të holla, që nuk kanë karakter të përhershëm dhe të përgjithshëm;
- ç) të ardhurat nga detyrimi ushqimor, të caktuara me vendim gjykatë;
- d) vlera e antidoteve, që punëdhënësi jep në natyrë, për personat e punësuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet

nga fondi i veçantë, për rastet e fatkeqësive në familje, për sëmundjet e gjata, për dëme, në raste fatkeqësish të mëdha natyrore, dhe për veprimtari të shquara;

e) vlera e shpenzimeve për të punësuarit, që kryejnë veprimtari jashtë qendrës së banimit, të cilat jepen bazuar në legjislacionin në fuqi dhe që nuk janë pjesë e pagës;

ë) honorarët apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.

Ushtrimi 10 (5 pikë)

Arbeni me profesion inxhinier, është aktualisht i punësuar pranë kompanisë New Construction shpk si drejtues teknik. Arbeni përfiton në bazë të kontratës së punës një page bruto në masën 200,000 lekë. Ai ka zgjedhur të vazhdojë të ushtrojë profesionin e tij përtej pensionit. Në muajin 1 Qershor ai mbush moshën e pensionit dhe ka kryer aplikimin për përfitimin e pensionit.

Kërkohet:

a. Llogarisni detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për Arbenin në muajin maj 2024 para daljes në pension dhe për muajin qershor pas daljes në pension. (3 pikë)

Zgjidhje (1.5 pikë llogaritja, 1.5 pikë konkluzioni që nuk do të ndryshojë)

Paga Bruto	200,000
Paga për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore	176,416
Kontributet e sigurimeve shoqërore punëdhënës 15%	26,462
Kontributet e sigurimeve shoqërore punëmarrës 9.5%	16,760
Total Kontribute Shoqërore	43,222
<hr/>	
Paga për efekt të llogaritjes së sigurimeve shëndetësore	200,000
Kontributet e sigurimeve shëndetësore punëdhënës 1.7%	3,400
Kontributet e sigurimeve shëndetësore punëmarrës 1.7%	3,400
Total Kontribute Shëndetësore	6,800

Llogaritja e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për muajin maj dhe qershor **nuk do të ndryshojë**, për shkak të daljes në pension. Sipas legjislacionit në fuqi, në rrethanat aktuale Arbeni nuk përfiton asnjë lehtësi, përjashtim apo trajtim ndryshe në llogaritje. Nga pagesat për sigurimet shoqërore pas daljes në pension, Arbeni nuk përfiton asnjë shtesë në pensionin e tij në vazhdim.

b. Po nëse Arbeni zgjedh të kalojë nga i punësuar, si i vetëpunësuar në formën e personit fizik, a do të ketë ndryshime në llogaritjen e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore? (2 pikë)

Përgjigje:

Përfituesit e pensionit të pleqërisë, që vetëpunësohen si të vetëm në sektorin privat, janë të përjashtuar nga detyrimi për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, sipas ligjit Nr. 64/2023 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nëse Arbeni zgjedh të kalojë nga i punësuar, në të vetëpunësuar i vetëm në formën e personit fizik, sipas ligjit Nr. 64/2023, ai përjashtohet nga detyrimi për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore. Agroni ka detyrimin për të paguar vetëm sigurimet shëndetësore në nivelin e pagës minimale, përkatësisht $80,000 \text{ leke} \times 3.4\% = 2,720 \text{ lekë}$ në muaj.